

VENDIM
Nr. 297, datë 18.11.2022

MBI SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 90, DATË 6.8. 2008, “PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘BIOPOWER GREEN ENERGY’ SHPK”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.11.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 1948 prot., datë 10.11.2022, “Mbi shfuqizimin e vendimit nr. 90, datë 6.8. 2008, ‘Për licencimin e shoqërisë ‘Biopower Green Energy’ sh.p.k.’, i ndryshuar”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 111, datë 19.5.2022, vendosi:

1. Pezullimin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s në lidhje me plotësimin e kushtit të vendosur në vendimin nr. 110, datë 26.4.2021, për depozitimin në ERE të lejes mjedisore të rinovuar nga shoqëria “Biopower Green Energy” sh.p.k.

2. Shoqëria të përditësojë ERE-n çdo 3 (tre) muaj, mbi ecurinë e pajisjes me lejen mjedisore të rinovuar.

3. Ky vendim është objekt rishikimi në çdo kohë nga ana e ERE-s, por jo më vonë se data 4.2.2023, kur është dhe afati i përfundimit të statusit “Investim/investitor strategjik procedure e veçantë”, të dhënë me vendimin e Komitetit të Investimeve Strategjike nr. 11/6, datë 4.2.2022.

- ERE, për këtë vendimmarrje, njoftoi shoqërinë me shkresën nr. 168/3, datë 1.5.2022.

- Shoqëria me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 168/4 prot., datë 17.10.2022, ka përcjellë vendimin e ri të Komitetit Strategjik të Investimeve (KIS) me nr. 11/13, datë 18.7.2022, i cili ka njohur si subjekt aplikues shoqërinë “Marseglia Green Energy” sh.p.k. dhe “Marseglia Group” S.p.A. dhe ka përcaktuar se projekti “Parku me erë” do të realizohet nga shoqëria Marseglia Green Energy” sh.p.k. dhe “Marseglia Group” S.p.A., dhe po ashtu ka kërkuar nga ERE nëse ekziston mundësia e kalimit të licencës aktuale tek shoqëria “Marseglia Green Energy” sh.p.k. ose revokimin e saj në zbatim të legjislacionit në fuqi.

- Nga përmbajtja e vendimit nr. 11/13, datë, parashikohen termat dhe kushtet e reja për zhvillimin e projektit, si më poshtë vijon:

- Me krijimin e shoqërisë “Marseglia Green Energy” sh.p.k. shoqëria “Biopower Green Energy” sh.p.k. ka transferuar të gjitha asetet, të drejtat dhe detyrimet te kjo shoqëri, e cila bëhet pronari i vetëm i dy shoqërive dhe mbështet po njësoj projektin e investimit strategjik për të cilin ka përfituar statusin e investitorit/investimit strategjik.

- Shoqëria “Marseglia Green Energy” sh.p.k. është krijuar me qëllim të posaçëm në zbatim të projektit të investimit strategjik, në përputhje me kërkesat e pikës 6, të VKM-së nr. 1028, datë 16.12.2015, “Për përcaktimin e marzheve, rregullave dhe dokumentacionit të garancive financiare të investimeve strategjike.

- Ky vendim evidenton edhe faktin se shoqëria duhet të rishikojë projektin teknik të investimit duke spostuar turbinat që prekin zonën e mbrojtur. Nga verifikimet e kryera nga shoqëria, rezulton se një sipërfaqe toke në të cilin ishte parashikuar të pozicionohej turbina W TG 36, e që deri para pak kohësh ka pasur statusin juridik “shtet”, në muajin tetor 2021, është regjistruar si pasuri “private”. Për sa më sipër subjekti investues konfirmon angazhimin se do të heqë prej projektit

turbinat në fjalë dhe për të mos ulur kapacitetin prodhues, do të shtojë kapacitetet e turbinave të mbetura. Në përfundim të dy parqet me erë do të vazhdojnë të gjenerojnë 234 mw.

- Po ashtu në këtë vendim përcaktohet se afati 2-vjeçar (dyvjeçar) i statusit strategjik fillon nga njoftimi i këtij vendimi, investitorit, nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (ASHZHI).

- Ndër të tjera, edhe AKZM ngarkohet nëpërmjet këtij vendimi që brenda 10 ditëve, të vërë në dispozicion të projektit të investimit kufijtë realë të gjurmës së saktë dhe koordinatat përkatëse të shtrirjes së Peizazhit të Mbrojtur (PM) “Lumi Buna–Velipojë”. Ndërsa subjekti investues brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga njohja me kufijtë realë të gjurmës së saktë dhe koordinatat përkatëse të shtrirjes së Peizazhit të Mbrojtur (PM) “Lumi Buna–Velipojë”, të paraqesë pranë Sekretariatit Teknik të KIS-it, projektin e përditësuar teknik të investimit, ku të reflektohet heqja e turbinave nga zona e mbrojtur dhe ruajtja e parametrave të veçantë të projektit, lidhur me kapacitetin prodhues.

- Nga takimet e zhvilluara me përfaqësuesit e shoqërisë, rezulton se ajo ka mbajtur të njëjtin qëndrim dhe ka bërë me dije se nga takimet e zhvilluara me Agjencinë Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve (AIDA), për të vijuar me aplikimet sipas procedurave ligjore duhet të merret më parë autorizimi paraprak nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE). Pa autorizimin paraprak të MIE-s, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) nuk mund të pranojë aplikimin për leje mjedisore, i cili sikurse dokumentuar edhe më herët në ERE nga shoqëria, është bërë dy herë dhe është refuzuar për arsyen e sipërcituar. Në këto rrethana, shoqëria është shprehur se po procedon me aplikim pranë MIE-s që më pas të mund të aplikojë sërish pranë MTM-së për t’u pajisur me leje mjedisore. Në përfundim shoqëria ka deklaruar se është e detyruar t’i nënshtrohet kërkesave të autoriteteve përkatëse në lidhje me marrjen e të gjitha lejeve dhe autorizimeve për të vijuar me zbatimin dhe vënien në punë të projektit eolik, kjo edhe në kuadër të Statusit të Investitorit Strategjik me të cilin është pajisur.

- Në vijim të vendimit të KIS, i cili ka pranuar ndryshimin e subjektit investitor nga “Biopower Green Energy” sh.p.k. në “Marseglia Green Energy” sh.p.k., si dhe deklarimeve të mëhershme të shoqërisë në lidhje me domosdoshmërinë e pajisjes me autorizim paraprak dhe ligjërisht më tej edhe me autorizim përfundimtar nga ana e MIE-s për të zhvilluar këtë projekt, vlerësojmë që në zbatim të legjislacionit në fuqi, licenca e dhënë shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k., nuk mund të vijojë më të jetë në fuqi, pasi shoqëria, duhet të ndjekë procedurat e nisura në lidhje me pajisjen me autorizim paraprak nga MIE dhe, rrjedhimisht, do duhet të vijojë me nënshkrim të marrëveshjes me Autoritetin Kontraktor, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi dhe më pas do duhet të paraqitet në ERE për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike.

- Shoqëria “Biopower Green Energy” sh.p.k., me vendimin nr. 90, datë 6.8.2008, nuk ka mbajtur vetëm licencën për të prodhuar energji elektrike nga centrali me erë, por edhe për ndërtimin, instalimin dhe shfrytëzimin e centraleve elektrik me erë. Aktualisht rezulton se ky projekt mbetet ende i përpiluar dhe licenca e prodhimit të energjisë elektrike e pashfrytëzuar. Po t’i referohemi legjislacionit në fuqi, dhënia e së drejtës për të ndërtuar centralet prodhuese të energjisë, nuk është më kompetencë e ERE-s.

- Për gjithë sa më sipër, bazuar edhe në kërkesën e vetë shoqërisë, vlerësohet të shfuqizohet vendimi nr. 90, datë 6.8.2008, “Për licencimin e shoqërisë ‘Biopower Green Energy’ sh.p.k.”, i ndryshuar. Me hyrjen në fuqi të shfuqizimit të këtij vendimi, licenca nr. 64, seria NPM08P, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrale me erë bëhet e pavlefshme.

- Në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, është parashikuar mundësia e shfuqizimit të një akti administrativ, me nismën e vetë organit, që ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të shfuqizimit të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

- Në zbatim të nenit 42, pikës 3, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, në lidhje me detyrimin e shërbimit publik, bëjmë me dije se shoqëria “Biopower Green Energy” sh.p.k., nuk ka asete që i shërbejnë ushtrimit të kësaj veprimtarie.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shfuqizojë vendimin nr. 90, datë 6.8.2008, për licencimin e shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k.

2. Licenca nr. 64, seria NPM08P, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrale me erë bëhet e pavlefshme.

3. Ky vendim është objekt rishikimi në çdo kohë nga ERE.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë palët e interesit në lidhje me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

ANËTAR I BORDIT
Maksim Shuli